



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik

01Nr. 104/02-4453/24
Kaçanik, 29.02.2024

Në mbështetje të nenit 11, 12.2 (d) dhe 17 (c) të Ligjit Nr.03/L-40 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 të datës 04 Qershor 2008), të nenit 17 të Ligjit Nr. 06/l-092 -për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/03 Prill 2019) si dhe Rregullores (QRK) nr. 09/2020- për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, të nenit 6 paragrafi 1. 2 (h) dhe (q) të Statutit të Komunës së Kaçanikut të datës 25.09.2008 dhe ndryshimi plotësimin e Statutit të Komunës së Kaçanikut 01.Nr.60/01-12895/2020 të datës 30.06.2020, të Propozim Vendimit 01Nr. 104/02-4453/24 prej datës 15.02.2024 të Kryetarit të Komunës nëpërmjet Drejtorisë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e mbajtur me 29 shkurt 2024, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË SHFRYTEZIM AFATSHKURTËR TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Me këtë Vendim formohet komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës në procedurën afatshkurtër në përbërje prej 5 anëtarëve, prej tyre dy (2) anëtarë të propozuar nga Kryetari i Komunës nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, dy (2) anëtarë të propozuar nga Kuvendi i Komunës nga radhët e anëtarëve të Kuvendit dhe një (1) anëtar ekspert nga shoqëria civile.
2. Komisioni si në pikën 1 të këtij Vendimi, ka këtë përbërje:

1. Besmir Krasniqi	anëtar (ekzekutivi)
2. Sadat Koxha	anëtar (ekzekutivi)
3. Brahim Imishti	anëtar (PDK)
4. Ernesta Krasniqi	anëtar (LVV)
5. Emrin Dema	anëtar (Shoqëria Civile)
3. Komisioni vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës është përgjegjës: Të sigurojë që konkursi i hapur të mbahet në përputhje me procedurat e Ligjit nr. 06/l-092 dhe Rregullores (QRK) – Nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, të sigurojë që dokumentet të janë në dispozicion për pjesëmarrësit në konkurrim, të sigurojë që konkursi është shpallur në web-faqen e komunës dhe tabelën e komunës për shpallje publike, të sigurojë konfidencialitet për personat ose subjektet që marrin pjesë në konkurrim.
4. Komisioni vlerësues i formuar me këtë vendim, do të zhvilloj procedurën vetëm për pronat të cilat do të jepen në shfrytëzim sipas Vendimit Paraprak 01Nr. 104/02-4455/24 të aprovuar me 29.02.2024.

5. Organet relevante të administratës dhe njësitë tjera të organeve të saja, do t'i ofrojnë përkrahje Komisionit Vlerësues.
6. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset: Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit.
7. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të autoritetit mbikëqyrës të MAPL, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: MAPL, Komisioni, Kryetari i Komunës, Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

